



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:140748
Datë: 27.09.2024
Numri i dokumentit: 06218995

CAP.nr.381/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren Naime Ahmeti, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Z.L. nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson, S.K. Avokat në Prishtinë, ndaj debitorit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – Qendra Klinike Universitare e Kosovës (SHSKUK - QKUK) në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbartimore përmbushje e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, CPC.nr.1070/2023 të datës 19.01.2024, jashtë seance me datë 26.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK), me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, CPC.nr.1070/2023 të datës 19.01.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar CPC.nr.1070/2023 të datës 19.01.2024, ka vendosur si në vijim: “REFUZOHET i pabazuar prapësimi i debitorit të përmbartimit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës SHSKUK-QKUK, me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Aktvendimit CPC.nr.1070/2023, të datës 20.10.2023, të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë. OBLIGOHET, debitori i përmbartimit, që kreditorit të përmbartimit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore (për përgjigje në prapësim) në shumën prej 156.00€, në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi”.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar pala debitore, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, ta aprovoj ankesën e debitorit dhe aktvendimin e atakuar ta prishë dhe lëndën ta kthej në rigjykim dhe rivendosje ose të njëjtin ta ndryshoj dhe ta hudhë poshtë propozimin për përmbarrim si të pa bazë.

Gjykata e Apelit, përmes gjyqtarës individuale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore (LPP) dhe gjeti se:

-Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori, përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit në bazë të dokumentit përmbarrues–Vendimit Nr. 01/21-1715/94, të datës 10.02.2020 të Inspektoratit të Punës në Prishtinë, dhe Vendimit Nr. 01/21 – 1178, të datës 18.11.2020 për Korrigjimin e Gabimeve për shumën e borxhit prej 1.926.32 euro, si dhe shpenzimet procedurale.

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim nga ana e kreditorit, ka marr aktvendimin CPC.nr.1070/23 të dt. 20.10.2023, me të cilin e ka lejuar përmbarrimin. Ndaj këtij aktvendimi, me dt.27.12.2023, prapësim ka paraqitur debitori, duke theksuar që urdhri vendimi në bazë të cilit është iniciuar procedura nuk është dokument i përshtatshëm për përmbarrim, andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar dhe të anulohet aktvendimi për përmbarrim CPC.nr.1070/23 të dt. 20.10.2023, si i pa bazë.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas prapësimit të debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar, CPC.nr.1070/2023 të datës 19.01.2024, me të cilin e ka refuzuar prapësimin e debitorit si të pabazuar, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se pas shqyrtimit të prapësimit të debitorit dhe përgjigjes në prapësim si dhe shikimit dhe vlerësimit të shkresave tjera të lëndës, ka gjetur se aktvendimi mbi përmbarrimin është marrë dhe caktuar në bazë të titullit përmbarrues konform nenit 24 par.3 të LPP-së dhe se prapësimi i debitorit i parashtruar kundër aktvendimit për përmbarrim është i pa bazuar, për faktin se nuk përmbushen asnjë nga shkaqet e parapara me dispozitat e nenit 71 të LPP-së, ngase debitori nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij, siç është përcaktuar me nenin 69 par 4 të LPP –së, në bazë të cilave shkaqe gjykata duhet ta aprovoj prapësimin si të bazuar. Tutje gjykata ka arsyetuar se dokumenti përmbarrimor në bazë të cilit është lejuar përmbarrimi Vendimi i Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94 i datës 10.02.2020, vendimi për Korrigjimin e Gabimeve nr. Nr.01/21-1178 i datës 18.11.2020, ka cilësinë e dokumentit përmbarrimor, ngase i njëjti përmban të gjitha të dhënat e kërkuara që i njëjti të konsiderohet si dokument përmbarrimor.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK, prandaj, në situatën konkrete të gjitha pretendimet ankimore të debitorit Gjykata e Apelit i konsideron të pabazuara dhe të paqëndrueshme, ngase nuk kanë bazë në prova konkrete.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, ka konstatuar drejtë faktin se vendimi i lëshuar nga Inspektorati i Punës 01 Nr.21-1715/94 i datës 10.02.2020, i korrigjuar me vendimin nr.01-21-1178 i datës 18.11.2020, në rastin konkret është dokument përmbarues, siç parashihet me dispozitën e nenit 22 paragrafi 1, pika 1.2 të LPP-së, e cila dispozitë përcakton se: *“Dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative”* dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21 të LPP-së, i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, e po ashtu i plotëson kushtet nga neni 24 paragrafi 3 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*, ndërsa në vendimin e Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94 i datës 10.02.2020, dhe vendimin mbi korrigjimin e gabimeve nr.01-21-1178 të datës 18.11.2020, shihet se debitori është detyruar që kreditorit t’i paguaj në emër të shpërblimit jubilar të tri pagave të tij mujore, në shumë prej 1.926.32 €.

Pretendimet ankimore të debitorit për shkelje të dispozitave ligjore nga neni 21, 24, 27 dhe neni 36 të LPP-së, neni 50 të Ligjit për Procedurën Administrative, neni 162 par.2 dhe 3, lidhur me nenin 391 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, se propozimi për përmbarim është paraqitur në kundërshtim me këto dispozita ligjore, për përmbarimin e vendimit të Inspektoratit të Punës, nuk janë pranuar nga Gjykata e Apelit, sepse në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim të nxjerrë në procedurë administrative, vendimi nuk është nxjerrë në procedurë kontestimore, andaj në rastin konkret procedura përmbarimore udhëhiqet nga parimi i rigorozitetit formal, pasi që vlerësohet vetëm përshtatshmëria e dokumentit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi në kuptim të përshtatshmërisë së titullit përmbarues që në rastin konkret vendimi i Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94 i datës 10.02.2020, dhe vendimi mbi korrigjimin e gabimeve nr.01-21-1178 të datës 18.11.2020, në bazë të cilëve është caktuar përmbarimi dhe i cili i plotëson kushtet ligjore nga nenet 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Po ashtu, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë nga pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore dhe

gjkata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore, por nuk ka gjetur se ekzistojnë rrethana apo shkaqe për të vendosur ndryshe në këtë çështje, prandaj nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe 209 paragrafi 1, pika (b), të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.381/2024, me datë 26.09.2024

Gjyqtarja
Naime Ahmeti